

2020

**RAPORT MBI PYETËSORIN PËR VLERËSIMIN E
MËSIMDHËNIES ONLINE NË FAKULTETIN E
SHKENCAVE TË NATYRËS, UT**

SEMESTRI I II-TË, VITI AKADEMIK 2019-2020



Përmbajtja

I. Baza ligjore

- A. Ligji nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*
- B. VKM nr.531 datë 11.09.2018 *“Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”*
- C. Urdhri Nr. 816, datë 26.12.2018, i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, *“Për miratimin e statutit të Universitetit të Tiranës”*
- D. Vendimi Nr. 84, datë 27.10.2018, i Bordit të Administrimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë *“Mbi akreditimin institucional të Universitetit të Tiranës”* për periudhën 2018-2022
- E. *“Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023”*

II. Pyetëtori

- A. Qëllimi i pyetësit
- B. Organizimi i pyetësit
- C. Përmbajtja e pyetësit
- D. Gjenerimi i të dhënave dhe ruajtja e anonimatit

III. Rezultatet

- A. Pjesëmarrja në pyetësor
- B. Analiza e të dhënave gjeneruar nga pyetëtori

IV. Konkluzionet

- A. Problematika të evidentuara
- B. Rekomandime në përgjigje të problematikave

Lista e shkurtimeve

✚ **FSHN-** Fakulteti i Shkencave të Natyrës

✚ **UT-** Universiteti i Tiranës

✚ **DSBCK-** Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës

✚ **SBC-** Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë

Baza ligjore

Në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu X "Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë", Neni 103 "Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë", pika 2,3,dhe 6 përcaktohet se :
"Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. ... Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitet për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. "

Në VKM nr.531 datë 11.09.2018 "Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë" parashikohen qartë standardet dhe kriteret për sigurimin e cilësisë së çdo programi studimi për secilin cikël. Konkretisht :

Në Shtojcën Nr.2 për « Standardet për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë BACHELOR, Standardi VI « Sigurimi i Cilësisë së Programeve të Studimit », përcaktohet sa vijon :

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër

të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formues dhe rezultateve të synuara të të nxënit

Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.

Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.

Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.

Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

Shtojca Nr.3 për « Standardet për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë MASTER PROFESIONAL dhe shtojca Nr.4 për « Standardet për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë MASTER SHKENCOR » parashikojnë të njëjtat standarde dhe kritere si cikli i parë i studimeve për sigurimin e cilësisë.

Urdhri Nr. 816, datë 26.12.2018, i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e statutit të Universitetit të Tiranës", Kreu X "Sigurimi i Cilësisë", Neni 138 "Sigurimi i brendshëm i Cilësisë në UT" si dhe Neni 139 "Parimet e funksionimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë" shprehen gjithashtu për SBC dhe sistemin për këtë qëllim.

Vendimi Nr. 84, datë 27.10.2018, i Bordit të Administrimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë "Mbi akreditimin institucional të Universitetit të Tiranës" për periudhën 2018-2022, i cili evidenton gjetjet në 5 fusha kryesore, cilëson si prioritet kryesor nevojën e zhvillimit dhe zbatimit të një politike formale për sjelljet e këqija akademike.

Në dokumentin "Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023", parashtrohet plani strategjik i veprimit në 6 fusha, për një periudhë kohore 5 vjeçare, sipas të cilit parashikohet përmirësim i kushteve dhe për pasojë cilësisë akademike të institucionit.

Në mbështetje të akteve ligjore renditur më sipër për sigurimin e cilësisë së UT dhe konkretisht FSHN, u organizua pyetëtori me titull "Pyetëtori për vlerësimin e mësimdhënies online në FSHN, UT, Semestri i II-të, Viti Akademik 2019-2020".

Duke konsideruar që mësimi për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020 u zhvillua elektronikisht (online), për shkak të mbylljes së institucioneve të edukimit në vend prej gjendjes së fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga pandemia e Covid-19, ky pyetësor u orientua drejtë mësimin online për të siguruar nga studentët një informacion mbi mësimdhënien në kushte të distancimit social.

Pyetëson

Qëllimi i pyetësorit

Qëllimi i pyetësorit është përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor. Kjo mund të realizohet vetëm përmes studenteve si baza kryesore e procesit mësimor. Për këtë studenteve u kërkohet të bëhen pjesë e pyetësorit, duke dhënë kontribut të drejtëpërdrejtë në evidentimin dhe adresimin e problematikave, për të përmirësuar me tej sistemin mësimor.

Organizimi i pyetësorit

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni sa më sipër përmendur si dhe detyrave funksionale të DSBCK, u organizua pyetëson për vlerësimin e mësimdhënies online për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020.

Duke qënë se DSBCK është një strukturë e re, pyetëson ju bë me dije departamenteve nëpërmjet Zv/Dekanit për kurrikulën e ciklit të parë dhe të dytë.

Departamentet kishin detyrimin të njoftonin profesorët, të cilët më tej, udhëzonin studentet për plotësimin e pyetësorit.

Për të siguruar pjesëmarrjen e studenteve, njëkohësisht u angazhua dhe Këshilli Studentor, me qëllim promovimin e nevojës dhe rëndësisë së këtij pyetësori.

Periudha kohore për zhvillimin e pyetësorit ishte muaji Korrik. Në platformën online të fakultetit, konkretisht në faqen zyrtare të internetit <http://www.fshn.edu.al/>, studentët mund të aksesonin pyetësorin dhe udhëzimet mbi të në link-un <http://www.fshn.edu.al/home/pyetesor-per-vleresimin-e-mesimdhenes-online-ne-fakultetin-e-shkencave-te-natyres-ut-semestri-i-ii-viti-akademik-2019-2020>, që më tej të drejtonte në 10 pyetjet e pyetësorit.

Pyetëtori u organizua përmes *google forms* dhe aksesi u kushtëzua vetëm për studentet e FSHN të cilët disponojnë llogari/adresë elektronike të fakultetit dhe rezultojnë studentë aktiv.

Koha totale që nevojte për plotësimin e pyetëtorit ishte 2-5 minuta.

Përmbajtja e pyetëtorit

Pyetëtori u organizua në 10 pyetje. Konkretisht:

Pyetja 1: A dispononi pajisjet e nevojshme elektronike për të ndjekur mësimin online?

Pyetja 2 Cilën nga pajisjet elektronike listuar më poshtë keni përdorur për mësimin online?

Pyetja 3: A kishit akses në internet përgjatë gjithë kohës që ndiqnit mësimin online?

Pyetja 4: A ishte i lehtë në përdorim sistemi ofruar nga FSHN për mësimin online? Ju lutem konsideroni dhe aspektet teknike: imazhi, teksti, zëri, kohëzgjatja etj.

Pyetja 5: A i përmbushët pritshmëritë ndaj lëndëve, në terma të përmbajtjes dhe objektivave, mësimi i të cilave u zhvillua online?

Pyetja 6: A ndiheni të sigurtë për plotësimin dhe përvetësimin e njohurive ose aftësive të paraqitura?

Pyetja 7: A mendoni se ndërveprimi, në raport me njëri-tjetrin dhe/apo me pedagogun, ishte i përshtatshëm për përmbajtjen e lëndës?

Pyetja 8: A do të ishit të gatshëm për kryerjen e vlerësimit të vazhdueshëm (aktivizim, punime, detyra etj.) dhe atij përfundimtar (test, provim etj.) në një platformë online?

Pyetja 9: A do të ishit të gatshëm për testimin e kurseve e-learning në të ardhmen për të siguruar plotësimin e nevojave akademike në fakultet?

Pyetja 10: A ju ka bërë mësimi online të ndryshoni ndonjë nga sjelljet apo praktikat tuaja të përditshmërisë?

Pyetjet u konceptuan si pyetje polare, pra vetëm me dy mundësi përgjigje, "PO" ose "JO", për ta lehtësuar dhe qartësuar qëndrimin e studentit mbi fushën nën diskutim; përjashtuar pyetjes së dytë e cila kërkonte që studentet të shpreheshin mbi pajisjet elektronike të përdorur për mësimin online.

Gjenerimi i të dhënave dhe ruajtja e anonimatit

Pas përfundimit të periudhës së pyetësorit, të dhënat u eksportuan automatikisht, falë sistemit të *google forms*, në një document *excel-i*, i cili përmbante si informacione kryesore: kohën e aksesimit të pyetësorit, emrin e përdoruesit dhe përgjigjet për secilën pyetje.

Të dhënat e gjeneruara u kontrolluan dhe analizuan nga DSBCK.

Është nën përgjegjësinë e DSBCK që pyetësi të administrohet duke ruajtur plotësisht anonimat. Në linjë me këtë, rezultatet do të publikohen pas përmbylljes së sezonit të provimeve, për të evituar çdo ndikim të mundshëm në vlerësimin përfundimtar të studentit.

Rezultatet


Pjesëmarrja në pyetësor

Pas eliminimit të dublikimeve, numri i studentëve pjesëmarrës në pyetësor është **245 studentë** nga totali prej **1317 i studenteve** në vitin e tretë bachelor, vitin e dytë master I shkencave dhe vitin e parë master professional.


Plotësimi i pyetësorit është kryer nga adresa elektronike e fakultetit emer.mbiemer@fshnstudent.info.

Të dhëna gjeneruar nga pyetësori


Rezultatet e pyetësorit janë paraqitur në formatin tabelar shprehur në përqindje, si më poshtë vijon:




Pyetja 2: Cilën nga pajisjet elektronike listuar më poshtë keni përdorur për mësimin online?




Pyetja 3: A kishit akses në internet përgjatë gjithë kohës që ndiqnit mësimin online?




Pyetja 4: A ishte i lehtë në përdorim sistemi ofruar nga FSHN për mësimin online? Ju lutem konsideroni dhe aspektet teknike: imazhi, teksti, zëri, kohëzgjatja etj.




Pyetja 5: A i përmbushët pritshmëritë ndaj lëndëve, në terma të përmbajtjes dhe objektivave, mësimi i të cilave u zhvillua online?




Pyetja 6: A ndiheni të sigurtë për plotësimin dhe përvetësimin e njohurive ose aftësive të paraqitura?




Pyetja 7: A mendoni se ndërveprimi, në raport me njëri-tjetrin dhe/apo me pedagogun, ishte i përshtatshëm për përmbajtjen e lëndës?




Pyetja 8: A do të ishit të gatshëm për kryerjen e vlerësimit të vazhdueshëm (aktivizim, punime, detyra etj.) dhe atij përfundimtar (test, provim etj.) në një platformë online?



Pyetja 9: A do të ishit të gatshëm për testimin e kurseve e-learning në të ardhmen për të siguruar plotësimin e nevojave akademike në fakultet?



Pyetja 10: A ju ka bërë mësimi online të ndryshoni ndonjë nga sjelljet apo praktikat tuaja të përditshmërisë?



Përfundime

Pyetjes për disponimin e mjeteve të nevojshme elektronike për ndjekjen e mëimit online, 88% e studentëve i janë përgjigjur pozitivisht, ku përqindjen më të lartë të pajisjeve elektronike përdorur në mësimin online e morri laptop-i dhe smart phone-i me afro 40% secili, për një total prej 80% të të gjithë pajisjeve të mundshme.

65% e studentëve pohojnë se kanë patur akses në internet përgjatë gjithë kohës me një diferencë prej 30% me studentët që nuk kishin patur akses.

Sistemi i mëimit online ofruar nga FSHN rezulton të ketë qënë i lehtë në përdorim sa i takon aspektit teknik (imazhi, teksti, zëri, kohëzgjatja etj.) pasi 81% e studentëve reflektojnë këtë qëndrim.

Megjithëse studentët ndahen me një diferencë prej vetëm 6% në qëndrimin e tyre sa i takon përmbushjes së pritshmërive ndaj lëndëve, në terma të përmbajtjes dhe objektivave, 63% e tyre ndihen të pasigurtë për plotësimin dhe përvetësimin e njohurive ose aftësive të paraqitura.

93% e studentëve të cilët nuk i përmbushën pritshmëritë ndaj lëndëve, në terma të përmbajtjes dhe objektivave, mësimi i të cilave u zhvillua online, ndihen të pasigurtë për plotësimin dhe përvetësimin e njohurive ose aftësive të paraqitura. Dhe prej këtyre 70% nuk do të ishin të gatshëm për kryerjen e vlerësimit të vazhdueshëm (aktivizim, punime, detyra etj.) dhe atij përfundimtar (test, provim etj.) në një platformë online.

Pavarësisht se, ndërveprimi, në raport me njëri-tjetrin dhe/apo me pedagogun, u vlerësua pozitivisht gati 2 herë më tepër se qëndrimi negativ, pak më shumë se gjysma e studentëve besojnë se nuk do të ishin të gatshëm për kryerjen e vlerësimit të vazhdueshëm (aktivizim, punime, detyra etj.) dhe atij përfundimtar (test, provim etj.) në një platformë online. 65% e tyre shprehen se janë të gatshëm nëse kjo platforme testohet fillimisht.

Mësimi online duket se ka ndryshuar sjelljen apo praktikën e përditshmërisë të thujtë 70% të studentëve, fakt që reflekton përshtatjen me politikat për menaxhimin e pandemisë në kushte të distancimit social.

Problematika të evidentuara

Nga organizimi dhe pjesëmarrja në pyetësor vihen re problematikat sa më poshtë vijon:

- Shumica e studentëve ndihen të pasigurtë për plotësimin dhe përvetësimin e njohurive dhe aftësive të paraqitura,
- Shumica e studentëve nuk do të ishin të gatshëm për kryerjen e vlerësimit të vazhdueshëm (aktivizim, punime, detyra etj.) dhe atij përfundimtar (test, provim etj.) në një platformë online.

Rekomandime në përgjigje të problematikave

Në përgjigje të problematikave të evidentuara, DSBCK propozon veprimet sa më poshtë vijon:

- > Verifikimin dhe vënien në punë të të gjithë adresave/llogarive online të studentëve që rezultojnë me status aktiv përgjatë vitit akademik,
- > Ofrimin e mjeteve alternativë studentëve të cilët nuk kanë pajisjet e nevojshme për ndjekjen e mësimit online,
- > Sigurimin e mënyrave të tjera që leksionet të arrijnë çdo student (si për shembull regjistrimin në video të leksioneve), veçanërisht ata që nuk kanë akses në internet,
- > Shqyrtimin e mundësisë për të ofruar asistencë teknike, dhe jo vetëm, përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të mësimit online, studentëve që kanë probleme me platformën online të mësimdhënies ofruar nga FSHN,
- > Evidentimin nga pedagogu i lëndës së pretendimeve të studentëve mbi pritshmeritë e pa përmbushura ndaj lëndës, njohurive dhe aftësive të pa plotësuara dhe të pa përvetësuara si dhe nderveprimin e munguar; në linjë me këtë hartimin e një programi të posaçëm për plotësimin e këtyre pretendimeve brenda periudhës pasuese të mësimdhënies (semestri i ri),
- > Shqyrtimin e propozimeve si nga pedagogët dhe nga studentët të metodave dhe teknikave për zhvendosjen në platformë online dhe dixhitalizim të vlerësimit të vazhdueshëm dhe përfundimtar në funksion të një vlerësimi të drejtë, objektiv, transparent dhe bashkëkohor.